



# GreenAL

**Udhëzues për aplikant**

**Grante 'të dedikuara'**

**Kodi i Thirrjes: 16510-G01**

Publikuar në datë 31 Korrik, 2024

Përditësuar në 25 Shtator, 2024

Aplikimet pranohen deri në datë 30 Qershor, 2027



## Përmbajtja

1. Përshkrimi i GreenAL.....	3
i) Territori i veprimit dhe partnerët .....	3
2. Grantet ‘e dedikuara’ .....	3
i) Konteksti.....	3
ii) Objektivat e thirrjes.....	5
iii) Prioritetet.....	5
3. Kriteret e aplikimit.....	5
i) Kush mund të aplikojë? .....	5
ii) Tipologjia e mbështetjes financiare .....	6
4. Rregulla të përgjithshme mbi aplikimin .....	6
5. Tema të mundshme .....	8
6. Aplikimi.....	8
i) Dokumentet e nevojshme .....	8
ii) Mënyra e dorëzimit .....	9
7. Vlerësimi.....	9
i) Vlerësimi administrativ.....	10
ii) Vlerësimi përmbajtësor .....	10
iii) Procedura e përzgjedhjes .....	12

### Shënim:

*Ky udhëzues ofron informacionin e nevojshëm për të gjithë Organizatat e Shoqërisë Civile në Shqipëri, që janë të interesuara për të aplikuar në thirrjen për Grante ‘të dedikuara’ të GreenAL. Udhëzuesi shpjegon qasjen, kriteret dhe rregullat e thirrjes. Për çdo informacion ose paqartësi, mund të na shkruani në [info@greenal.al](mailto:info@greenal.al).*



## 1. Përshkrimi i GreenAL

Projekti GreenAL 'Mbështetja e Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile 2024-2027' synon të fuqizojë organizatat mjedisore të shoqërisë civile Shqiptare, dhe jo vetëm, për të marrë pjesë dhe kontribuar në mënyrë efektive dhe direkte në procesin e negociatave për anëtarimin në BE, me fokus kryesor Kapitullin 27.

Nëpërmjet mbështetjes financiare dhe teknike përgjatë viteve të zbatimit, projekti GreenAL kërkon të kontribuojë në mënyrë proaktive në adresimin e sfidave mjedisore, nëpërmjet advokimit, ndikimit në politika dhe monitorimit nga niveli lokal në atë kombëtar duke pasur në fokus përfshirjen aktive të komuniteteve. Përgjatë kohëzgjatjes së tij GreenAL do përqendrohet në 3 tematika kryesore: **Ndryshimet Klimatike, Ndotja dhe Natyra**.

Ky projekt financohet nga Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Sida, me fondet e Qeverisë Suedeze dhe zbatohet nga Partnerët GreenAL, Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit në bashkëpunim me organizatat VIS Albania dhe COSV - Cooperazione per lo Sviluppo.

Për më tepër informacion në lidhje me elementet kryesore të projektit GreenAL, referohuni [Pasqyrës së Programit këtu](#).

### i) Territori i veprimit dhe partnerët

Projekti GreenAL do të zbatohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Për të siguruar një menaxhim të mirë të projektit dhe një mbështetje të vazhdueshme të organizatave dhe grupeve të interesit, Partnerët kanë vendosur të ndajnë territorin e vendit në 3 rajone kryesore, me një Partner përgjegjës për secilën territor:

- Rajoni **Verior**, i cili përfshinë qarqet Kukës, Dibër, Shkodër dhe Lezhë, është nën përgjegjësinë e partnerit VIS Albania.
- Rajoni **Qendror**, i cili përfshinë qarqet Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Fier, është nën përgjegjësinë e partnerit Co-PLAN.
- Rajoni **Jugor**, i cili përfshinë qarqet Vlorë, Berat, Korçë, Gjirokastrë, është nën përgjegjësinë e partnerit COSV.

Secili nga Partnerët do të ofrojë asistencë dhe mentorim për të gjithë përfituesit e granteve të cilët do të duan të aplikojnë e zbatojnë projekte në rajonet respektive duke synuar:

1. Mbështetjen e OSHC-ve mjedisore për të konsoliduar pozicionin e tyre në bashkinë/rajonin në të cilin operojnë;
2. Rritjen e sinergjive ndërmjet OSHC-ve, ekspertëve, aktivistëve, bizneseve dhe institucioneve publike;
3. Rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit dhe grupeve të interesit për çështjet mjedisore.

## 2. Grantet 'e dedikuara'

### i) Konteksti

Shqipëria është një vend i cili konsiderohet i cënueshëm ndaj ndryshimeve klimatike<sup>1</sup>, kryesisht nga mungesa e ujit, thatësitat, rritja e temperaturave, rritja e nivelit të deteve, erozioni bregdetar, përmytjet, zjarret etj., dhe për

<sup>1</sup> Indeksit të Riskut Botëror 2023



këtë arsye nevojitet të merren masa paraprake për reduktimin e riskut dhe ndërgjegjësimin e komuniteteve lidhur me efektet dhe pasojat e tyre. Qeveria Shqiptare në vitet e fundit ka bërë disa hapa përpara në hartimin e planeve strategjike, legjisacionit dhe ratifikimin e marrveshjeve ndërkombëtare e evropiane të cilat e vendosin këtë të fundit përballë sfidës së përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga këto dokumenta.

Nga njëra anë është hartimi i dokumentave, të cilat janë shumë të nevojshme, e nga ana tjetër është mirë zbatim i tyre për të arritur objektivat e vendosur. Në këtë drejtim, raportimet të cilat vijnë nga Organizata të Shoqërisë Civile (OSHC) të ndryshme mjedisore por edhe nga ana e organeve zyrtare nëpërmjet, Raportit të Gjëndjes në Mjedis 2022, Raporti Vjetor i Kriminalitetit 2022 dhe Progres Raporti 2023 i KE-së për Shqipërinë referojnë se në Republikën e Shqipërisë ka abuzime të cilat kryen në kurriz të mjedisit duke ndikuar në degradimin e tij. Problematikat mjedisore lidhen kryesisht me ndotjen e ujit, ajrit e tokës, prerje të paligjshme dhe zjarrvënie në pyje, mungesën e masave dhe ndërgjegjësimin e grupeve të interesit për pasojat e ndryshimeve klimatike në sektorë të ndryshëm.

Zhvillimi i viteve të fundit ka sjellë edhe ndryshime të qenësishme në përdorimin e tokës për të akomoduar nevojat për zhvillim duke i hapur vendin ndërtimit të objekteve rezidenciale (edhe në zona të mbrojtura), tregtare dhe infrastrukturore dhe duke rritur presionin ndaj mjedisit dhe burimeve natyrore në favor të zhvillimit ekonomik, element të cilët nuk janë në linjë me parimet e zhvillimit të qendrueshëm.

Nga disa OSHC evidentohet se miratimi i legjisacionit apo projekteve madhore zhvillimore të cilat kanë impakt direkt në mjedis jo gjithmonë ndjekin hapat ligjor referuar ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Por edhe në ato raste kur këto procese zhvillohen, komunitetet ndihen të papërfaqësuar dhe OSHC-të nuk kanë një përgjigje/feedback lidhur me sugjerimet që kanë dhënë dhe nëse ato janë marrë në konsideratë apo jo.

Aktualisht konsultimi digjital, nëpërmjet [Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike](#), është metoda kryesore e konsultimit publik. Grupet e interesit vlerësojnë se kjo platformë nuk është shumë miqësore me përdoruesit, të cilët e konsiderojnë më shumë si një platformë informimi se sa një hapësirë ndërveprimi<sup>2</sup>, duke ndikuar në shkurajimin e tyre në përdorimin efektiv të saj.

Në këtë drejtim, për t’i dhënë mundësinë OSHC-ve, si përfaqësues të zërit të komuniteteve, **GreenAL do të ofrojë mbështetje financiare në formën e granteve ‘të dedikuara’ me qëllim lehtësimin/nxitjen për t’ju përgjigjur një zhvillimi me impakt mjedisor e cila mund të konsiderohet urgjente dhe kërkon një reagim për ta sjellë në vëmendje të qytetarëve dhe vendimmarrësve me synim ndërgjegjësimin për marrjen e masave dhe adresimin e problematikës.**

**“Urgjencë mjedisore”** e përkufizojmë si një ngjarje e papritur/paparashikuar mjedisore që cënon mirëqenien publike dhe që kërkon një veprim dhe reagim nga shoqëria civile dhe qytetarët, në nivel lokal, rajonal (e shtrirë në disa bashki ose qarqe) apo kombëtar.

**“Zhvillim me impakt mjedisor”** e përkufizojmë si një zhvillim i caktuar në sektorë të ndryshëm, përfshirë zhvillimet legjislativë, një situatë emergjente mjedisore apo një projekt zhvillimor, i cili impakton ndjeshëm mjedisin dhe nxit grupet e interesit për të advokuar për një vendimmarrje më të mirë.

---

<sup>2</sup> Raport Studimor: Një dekadë nga ligji për konsultimin publik në Shqipëri: Thirrje për reformë. IDM, 2023.

<https://idmalbania.org/sq/raport-studimor-nje-dekade-nga-ligji-per-konsultimin-publik-ne-shqiperi-thirrje-per-reforme/>



## ii) Objektivat e thirrjes

- Mbështetja e OSHC-ve për të reaguar dhe vepruar ndaj një zhvillimi me impakt mjedisor i cili cënon mirëqenien publike;
- Nxitja e angazhimit komunitar dhe rritja e presionit pozitiv për transparencë dhe llogaridhënie në proceset hartimit të politikave, strategjive apo projekteve zhvillimore me impakt të ndjeshëm në mjedis.

## iii) Prioritetet

- Zbatimi i fushatave informuese e advokuese për të nxitur reagimin në adresmin e çështjes së ngritur;
- Bashkëpunimi ndërmjet OSHC-ve, komuniteteve, institucioneve, medias;
- Angazhimi në mënyrë aktive i komuniteteve në zonën e zbatimit të projektit por edhe më gjerë (varësisht çështjes së ngritur);
- Fuqizimi i komuniteteve për t'u organizuar në mënyrë të pavarur për çështje me interes publik;
- Përdorimi i metodave tradicionale dhe inovative<sup>3</sup> për të rritur vizibilitetin e nismës/projektit të zbatuar.

## 3. Kriteret e aplikimit

**Grantet 'e dedikuara' do të jenë të disponueshme përgjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit GreenAL (2024 – 2027) me procedura të thjeshtuara, për të siguruar një përgjigje në kohë për ato çështje urgjente ose zhvillime të caktuara në sektorin e mjedisit.**

Çdo aplikim për grant 'të dedikuar' **duhet** të plotësojë kriteret e mëposhtme:

1. Iniciativa e sygjëruar të lidhet me qëllimin, objektivat dhe prioritetet e thirrjes për grantet 'e dedikuara' si dhe të lidhet me objektivin e përgjithshëm dhe objektivat specifike të projektit GreenAL;
2. Çështja e identifikuar duhet të jetë një kauzë së cilës i nevojitet një reagim, veprim ose përgjigje për të mos lejuar humbjen e rëndësisë së saj.

Aplikimet pranohen çdo ditë pune nga momenti i publikimit të kësaj thirrje deri në **30 Qershor, 2027**.

### i) Kush mund të aplikojë?

Përmes granteve 'të dedikuara' do mbështeten **Organizatave e shoqërisë civile** (OSHC<sup>4</sup>) me minimumi 1 (një) vit përvojë (nga regjistrimi në gjykatë) dhe me përvojë të evidentuar në projekte mjedisore.

Gjithashtu organizatat aplikuese duhet:

- Të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Shqipëri;

<sup>3</sup> Metodë, ide apo qasje e re e pazbatuar më parë;

<sup>4</sup> Organizata të shoqërisë civile janë organizata jofitimprurëse të cilat janë regjistruar dhe funksionojnë në përputhje me legjislacionin shqiptar (Ligji 'Për Organizatat Jofitimprurëse' Nr.8788, datë 7.5.2001) dhe ushtrojnë veprimtari në territorin e Shqipërisë.



- Të mos kenë konflikte interesi me asnjë nga organizatat partnere të GreenAL si edhe mbivendosje të aktiviteteve me projekte që janë ende nën marrëdhënie kontraktuale. Nëse gjatë zbatimit të marrëveshjes lind ndonjë konflikt interesi, përfituesi duhet të njoftojë menjëherë organizatën Grant Dhënëse.

Partneriteti **nuk** është i detyrueshëm për këto lloj grantesh, por në rastet e **partneritetit** bashkë-aplikant mund të jenë:

1. OSHC;
2. Institucione kërkimore ose të arsimit të lartë;
3. Organe të medias (Media e shkruar, Televizione, Radio, etj.)

Roli i aplikantit kryesor dhe bashkë-aplikantëve duhet të dali qartë në projekt propozim. Gjithashtu aplikanti kryesor **duhet** të ketë një marrëveshje partneriteti me shkrim me bashkë-aplikantët e projektit. Në marrëveshje duhet të specifikohet roli specifik i gjithsecilit prej partnerëve.

**Shënim:** Përfituesit e granteve 'të dedikuara' **nuk humbasin** të drejtën për të aplikuar tek tipologjitë e tjera të granteve që do ofrohen nga GreenAL.

## ii) Tipologjia e mbështetjes financiare

**Vlera maksimale e grantit:** 5,000 EUR

**Kohëzgjatja e zbatimit të projektit:** 3 – 6 Muaj

**Shtrirja territoriale:** Në të gjithë Shqipërinë

**KUJDES!** Vlera totale në dispozicion për këtë thirrje është 35,000 EUR dhe vlera maksimale e grantit është 5,000 EUR. Numri i pritshëm i granteve që do shpërndahen është të paktën 7 (Shtatë) përgjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit GreenAL. Aplikimet do të miratohen vazhdimisht deri në disbursimin e të gjitha fondeve në dispozicion.

## 4. Rregulla të përgjithshme mbi aplikimin

**Aktivitetet të lejuara,** janë ato aktivitete që:

- Vijnë si përgjigje e ngjarjeve ose zhvillimeve urgjente me impakt të theksuar në mjedis dhe që çënojnë mirëqenien publike;
- Përfshijnë krijimin dhe zbatimin e fushatave informuese për çështjen e ngritur, nëpërmjet shpërndarjes së pankartave, daljeve në mediat lokale/kombëtare, advokim në median e shkruar dhe atë vizive, postimeve të targetuara në rrjete sociale, etj.;
- Mundësojnë dialog me politikë-bërësit lokal/rajonar/kombëtar, OSHC dhe me grupe të tjera interesi;
- Angazhojnë në mënyrë aktive komunitetet lokale/rajonale për të advokuar mbi çështjen e ngritur nëpërmjet takimeve, trajnimeve, etj.;
- Rrisin kapacitetet e komuniteteve lokale për mënyrat e ndryshme se si ata mund të adresojnë çështje që i çënojnë mirëqenien publike (nëpërmjet trajnimeve, mentorimit, mbështetjes, mobilizimit, etj.);
- Prezantojnë modele inovative për trajtimin e çështjes së ngritur në nivel lokal/rajonar/kombëtar;
- Ofrojnë alternativa për zgjidhjen e problematikës së ngritur nëpërmjet hartimit të dokumenteve/letrave të pozicionimit;
- Mbështesin kërkimin dhe raportimin të bazuar në fakte dhe të dhëna nga terreni.

**Shënim:** Kjo listë nuk është shteruese



**Aktivite të palejueshme**, janë ato aktivite që:

- Mund të parashikohen/organizohen paraprakisht;
- Zëvendësojnë kompetencat e pushtetit vendor;
- Bëjnë financimin e individëve për të marrë pjesë në seminare, konferenca dhe kongrese për qëllime personale;
- Kryejnë investime në pronë apo favor të subjekteve private.

**Kosto të pranueshme janë kostot që:**

- Janë të lidhura me aktivite të kryera gjatë zbatimit të nismës/projekt propozimit dhe që janë specifikuar në kontratë;
- Pasqyrohen në buxhetin e përgjithshëm të aktivitetit (në formatin e buxhetit);
- Janë të nevojshme për zbatimin e aktiviteve;
- Mund të gjurmohen dhe verifikohen në origjinë, veçanërisht të regjistruara në regjistrat kontabël të Përfituesit të Grantit dhe të përcaktuara në përputhje me standardet e zbatueshme të kontabilitetit të Republikës së Shqipërisë;
- Janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm tatarimor;
- Respektojnë rregullat e kombësisë dhe origjinës.

**Si kosto të pranueshme nga Përfituesit e Granteve konsiderohen:**

- Kostot e nevojshme për zhvillimin e aktiviteve të projektit;
- Kostot e stafit të caktuar në projekt-propozim, që korrespondojnë me pagat aktuale bruto duke përfshirë tarifën e sigurimeve shoqërore dhe kostot e tjera të lidhura me shpërblimin;
- Shpenzimet e udhëtimeve dhe dietave për personelin dhe personat e tjerë që marrin pjesë në projekt, me kusht që të jenë kosto reale të konfirmuara nga dokumente mbështetëse.

**E rëndësishme:** Vini re se taksat, përfshirë TVSH-në, do të aprovohen si kosto të pranueshme vetëm kur të plotësohen kushtet e mëposhtme (dhe të konfirmuara nga dokumentet mbështetëse):

- Taksat e vlerës së shtuar nuk janë të rimbursueshme në asnjë mënyrë;
- Sipas praktikës, ato do të përballohen nga përfituesi; dhe
- Ato pasqyrohen qartë në projekt propozim.

**Kosto të papranueshme, përfshijnë:**

- Borxhe dhe tarifën e shërbimit të borxhit (interesat);
- Dispozita për humbje ose detyrime të mundshme në të ardhmen;
- Kosto të deklaruara nga Përfituesi dhe të financuara nga donatorë ose nga veprime të tjera të financuara nga Sida;
- Humbjet e këmbimit valutor;
- Kredi për palët e treta;
- Kostot e pagave të personelit të administratës shtetërore, publike;
- Blerje pajisjesh;
- Kosto të ndryshme zyre;
- Shpenzime që i përkasin një periudhe më të gjatë sesa implementimi i projektit.



## 5. Tema të mundshme

Do të trajtohen me prioritet aplikime që trajtojnë çështje të cilat përfshihen tek fushat prioritare të specifikuar në [Pasqyrën e Programit të GreenAL](#). Fushat prioritare të reflektuara në Pasqyrën e Programit paraqesin fushat që konsiderohen si më kryesore nga grupet e interesit dhe organizatat e konsultuara gjatë zbatimit të projektit.

Nuk do të jetë penalizues fakti nëse një organizatë paraqitet me një aplikim që nuk i përmbahet fushave prioritare që reflektohen, por do të vlerësohet nëse nisma e propozuar sjell risi, apo është mëse aktuale, për komunitetin në fjalë dhe jo një përsëritje apo riciklim i projekteve të mëparshme.

Për secilën nga tre tematikat në fokus të GreenAL, si disa nën-tema potenciale për t'u trajtuar mund të përmendim:

- Ngjarje të paparashikuara, si p.sh. ndotja e ujit të pijshëm, marrja flakë e vendgrumbullimeve të mbeturinave urbane, fatkeqësi natyrore, etj.;
- Zhvillime legislative që mund të sjellin përkeqësim të situatës aktuale mjedisore;
- Investime zhvillimore kundër mirëqënies publike;
- Zhvillime që sjellin përkeqësim të aksesit të komunitetit në ujë të pijshëm, energji, etj.;
- Zhvillime që kufizojnë aksesin teritorial të komunitetit;

**Shënim:** Kjo listë nuk është shteruese

## 6. Aplikimi

Procesi i aplikimit dhe të vlerësimit kalon në hapat e mëposhtme:

1. Publikimi i thirrjes;
2. Dorëzimi i projekt propozimit të plotë së bashku me dokumentet mbështetëse;
3. Vlerësimi i aplikimeve të marra nga ana administrative (kriteret administrative dhe dokumentet e dorëzuara) dhe nga ana përmbajtësore;
4. Njoftimi i vlerësimit tek aplikantët;
5. Procesi i negocimit dhe kontraktimi.

### i) Dokumentet e nevojshme

Aplikimi duhet të kryhet në gjuhën Shqip dhe dokumentet që duhen dorëzuar janë si më poshtë:

1. **Formati i aplikimit të propozimit të plotë (Shtojca 1)**
2. **Buxheti (Shtojca 2)**
3. **Dokumentet administrative<sup>5</sup>:**
  - Vendimi i regjistrimit në gjykatë (*kopjo elektronike*);
  - Statuti dhe Akti i Themelimit të OSHC (*kopjo elektronike*);
  - Regjistrimi në Zyrën e Tatim-Taksave (NIPT) (*kopje elektronike*);
  - Profili Organizativ dhe CV e organizatës aplikuese ku evidentohet qartë përvoja e punës në minimalisht tre (3) projekte mjedisore;

<sup>5</sup> Të gjitha dokumentet administrative të dorëzohen si një paketë e vetme në PDF.





- CV të personave kyç të cilët do të përfshihen në projekt;
- Marrëveshje Bashkëpunimi (në rast partneriteti);

**Shënim:** Formatet e aplikimit dhe buxhetit mund të gjenden në webfaqen e [greenal.al](http://greenal.al).

## ii) Mënyra e dorëzimit

Për një proces sa më të thjeshtë, aplikimi për grantet 'e dedikuara' do të kryhet **vetëm në formatin ONLINE** në faqen [greenal.al](http://greenal.al), në hapsirën e granteve 'të dedikuara' [këtu](#).

Përgjatë kryerjes së aplikimit, **kini parasysh:**

- Të plotësoni të gjithë informacionet e kërkuara tek tabela e aplikimit (Emri i aplikantit, adresa e email-it, numri i kontaktit)
- Të ngarkoni të gjithë dokumentet e kërkuara sipas hapsirave përkatëse në formatin PDF. Të gjitha dokumentet e ngarkuara **nuk duhet të kalojnë 2 MB**. Këto dokumente janë:
  1. Format i aplikimit të propozimit të plotë (që përfshinë Deklaratën e aplikantit dhe Mandatin e partner-it, në rast partneriteti)
  2. Buxheti
  3. Paketa e dokumenteve administrative (të renditura më sipër)
- Pasi të siguroni që të gjitha informacionet dhe dokumentet e nevojshme janë ngarkuar, klikoni **'Dërgoni'**.

Pas dërgimit të aplikimit do ju vijë, në adresën e postës elektronike të vendosur në aplikim, një mesazh automatik konfirmues që aplikimi juaj është dorëzuar.

**KUJDES!** Siguroni që të dorëzoni të gjitha dokumentet e kërkuara. Aplikimet me mungesë dokumentacioni dhe që nuk plotësojnë rregullat e vendosura, do të refuzohen.

## 7. Vlerësimi

Pas dërgimit të aplikimit, vlerësimi do të kryhet brenda 10 - 15 ditëve (ditë pune) nga momenti i marrjes së mesazhit konfirmues.

Një Komision i dedikuar do të ngrihet posaçërisht me vendim të brendshëm nga Co-PLAN, anëtarët e të cilit do të mandatohen për të siguruar një vlerësim objektiv, të paanshëm dhe profesional, ndaj projekt – propozimeve të paraqitura.

Vlerësimi i aplikimeve do të kalojë në 3 (tre) hapa: vlerësim administrativ, vlerësim përmbajtësor dhe procedurë përzgjedhjeje.

**KUJDES!** Në rast të pushimeve zyrtare, procesi i vlerësimit të aplikimeve mund të zgjatet me ditët respektive të pushimeve.



## i) Vlerësimi administrativ

Përgjatë **vlerësimit administrativ** do të kontrollohen detajet si më poshtë:

Kriteret Administrative	Po	Jo	Komente
1. Propozimi është dorëzuar brenda afatit dhe rregullave			
2. Aplikanti ka mbi 1 (një) vit eksperiencë (e vërtetuar me Vendimin e Regjistrimit në Gjykatë)			
3. Aplikimi ka respektuar formatin e kërkuar (A janë plotësuar të gjitha pikat në format?)			
4. Propozimi është në gjuhën shqipe			
Dokumentet Mbështetës	Po	Jo	Komente
1. Vendimi i Regjistrimit në Gjykatë (kopjo elektronike)			
2. Statuti dhe Akti i Themelimit të OSHC (kopjo elektronike);			
3. Regjistrimi në Zyrën e Tatim-Taksave (NIPT) (kopje elektronike)			
4. Profili Organizativ dhe CV e organizatës aplikuese			
5. CV të personave kyç të cilët do të përfshihen në projekt			
6. Marrëveshje Bashkëpunimi (në rast partneriteti)			
Buxheti dhe kohëzgjatja	Po	Jo	Komente
1. Buxheti total i projektit është brenda limiteve të kërkuara			
2. Kohëzgjatja e projektit është nga 3 deri në 6 muaj			

Procesi i vlerësimit të granteve do të vazhdojë vetëm për aplikantët të cilët kanë kaluar fazën e vlerësimit administrativ. Të gjithë ata aplikant të cilët nuk plotësojnë kërkesat e sipërpërmendura do të s'kualifikohen dhe respektivisht do të njoftohen.

## ii) Vlerësimi përmbajtësor

Procesi i **vlerësimit përmbajtësor** përfshinë shqyrtimin e cilësisë së aplikimeve, së bashku me buxhetin e propozuar dhe kapacitetin e aplikantëve, të cilët do të vlerësohen duke përdorur kriteret e vlerësimit të plotë që janë në tabelën më poshtë me referencë seksionet e formatit të aplikimit.

Kriteri i vlerësimit	Rezultati maksimal (pikë)
<b>1. Kapaciteti operacional / teknik</b>	<i>Referenca me shtojcën 1: Kapitulli 4.5, 5 dhe 6</i>
A ka aplikanti kapacitet të mjaftueshëm menaxhues dhe ekspertizë teknike (përfshirë stafin e brendshëm dhe të jashtëm) si dhe aftësinë për të menaxhuar buxhetin dhe për të adresuar çështjet mjedisore të propozuara nëpërmjet aktiviteteve të parashikuara?	10 (pikë)
<b>2. Rëndësia e veprimit</b>	<i>Referenca me shtojcën 1: Kapitulli 4 nënpika i, Kapitulli 4.1, 4.2 dhe 4.3</i>
Sa i rëndësishëm është propozimi për t'u përgjigjur ndaj një zhvillimi urgjent të aktualitetit mjedisor?	20 (pikë)
Sa qartë janë përcaktuar dhe zgjedhur strategjikisht aktorët e përfshirë në projekt (përfituesit përfundimtarë dhe grupet e synuara) dhe si do të përfshihen në aktivitetet e parashikuara?	5 (pikë)
A janë përcaktuar qartë nevojat e aktorëve dhe a i adreson propozimi në mënyrë të përshtatshme?	5 (pikë)
<b>3. Projektimi i veprimit</b>	<i>Referenca me shtojcën 1: Kapitulli 4 nënpika ii, Kapitulli 4.1, 4.3, 4.4, 4.5 dhe 5.</i>
Sa koherent është modeli i përgjithshëm i veprimit? Në veçanti, a pasqyron ajo analizën e problemeve, duke marrë parasysh faktorët e jashtëm dhe palët e interesuara përkatëse?	10 (pikë)
A është veprimi i realizueshëm dhe i qëndrueshëm në lidhje me objektivat dhe rezultatet e pritura?	10 (pikë)
<b>4. Efektiviteti dhe realizueshmëria e propozimit</b>	<i>Referenca me shtojcën 1: Pika 4 nënpika iii, Kapitulli 5</i>
A sjell risi në adresimin e problemit modeli i propozuar nga aplikanti?	5 (pikë)
A është i qartë dhe i realizueshëm plani i veprimit dhe a janë paraqitur rezultatet dhe treguesit mbi të cilët do vlerësohet përmbushja e objektivit të propozimit?	5 (pikë)
<b>5. Buxheti dhe efektiviteti i kostos</b>	<i>Referenca me shtojcën 1: Kapitulli 4.3, 5 dhe 6</i>
A janë pasqyruar në mënyrë efektive kostot e aktiviteteve në buxhetin e propozuar?	10 (pikë)
A është racional raporti midis kostove dhe rezultateve të pritura?	10 (pikë)
<b>6. Qëndrueshmëria</b>	<i>Referenca me shtojcën 1: Kapitulli 4.6, 4.5, 4.4</i>
A ka të ngjarë që projekti i propozuar të ketë një ndikim të qëndrueshëm dhe pozitiv tek grupet e synuara?	5 (pikë)
A e përfshinë projekti i propozuar mundësinë për replikim dhe zgjerim të qasjes së përdorur dhe të shpërndarjes së informacionit?	5 (pikë)
<b>PIKËT TOTALE MAKSIMALE</b>	<b>100 (pikë)</b>



Vetëm aplikimet me **minimalisht 70 pikë** do të konsiderohen për fazën përfundimtare të përzgjedhjes së aplikimit fitues.

Përgjatë vlerësimit të aplikimeve **do merren në konsideratë** edhe:

- Përputhshmëria e projekt-propozimit me qëllimin, objektivat dhe prioritetet e thirrjes si dhe me objektivin e përgjithshëm dhe objektivat specifike të projektit GreenAL;
- Relevanca e urgjencës ose zhvillimit të parashtruar në aplikim dhe qasja e propozuar për ta trajtuar atë;
- Novacioni i idesë së propozuar;
- Përputhshmëria ndërmjet qëllimit dhe aktiviteteve të parashikuara.

### iii) Procedura e përzgjedhjes

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, aplikantët do të **njoftohen për vendimin në lidhje me aplikimin** nëpërmjet email-it. Në komunikimin përcjellës për njoftimin e rezultatit do të paraqiten pikët e grumbulluara (mesatare e vlerësimit e të gjitha vlerësimeve nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit) për aplikantin sipas formatit të vlerësimit.

**Ankimimi:** Nëse aplikanti beson se është vlerësuar negativisht si rezultat i ndonjë gabimi apo parregullsie gjatë procesit të vlerësimit mund të bëjë ankimim brenda 5 (pesë) ditëve (ditë pune) nga dita që ka marrë njoftim për refuzim. Ankimimi duhet të kryhet me shkrim, nëpërmjet email-it ose postës. Ankesa do të shqyrtohet dhe përgjigja do të kthehet brenda 10 ditëve (ditë pune) që nga paraqitja me shkrim e ankimit.

**Kontraktimi:** Përpara nënshkrimit të kontratës, Co-PLAN (si përgjegjës për zbatimin e skemës së granteve) **rezervon të drejtën për të negociuar me aplikantin** në mënyrë që të sigurojë efikasitetin maksimale për shpenzimet e parashikuara në kuadër të këtij projekti. Në këtë linjë, Co-PLAN mund t'i sygjerojë aplikantëve fitues ndryshimet përkatëse në zërat e buxhetit për të qënë në linjë me parimet e përgjithshme të skemës së granteve.

**Pagesa** do të kryhet në dy faza:

1. Pas nënshkrimit të kontratës do të kalohet 70 % e shumës,
2. Pagesa përfundimtare prej 30% do të transferohet pas miratimit të përditësimeve të raportit përfundimtar narrativ dhe financiar.

**Raportimi:** Dorëzimi i një raporti përfundimtar narativ dhe financiar për zbatimin e projektit, 30 dite pas mbarimit të tij.

***E rëndësishme:*** Parandalimi dhe eliminimi i çdo ndërhyrjeje arbitrare dhe/apo favorizuese është prioritet për Co-PLAN dhe partnerët. Procesi do të jetë transparent dhe informacioni në të gjithë hapat e tij do të jetë lehtësisht i aksesueshëm.